

VITI i IV — QERSHUER 1932 — Nr. 6

NORMALISTI

Jo në dijën, por në
vullnetin e fortë
qëndron vlera
e njeriut,

HERBART.

Drejtimi:
E përkohëshme "NORMALISTI,"
Shkolla Normale
Elbasan.

Shtypshkronja "SAIDE," Elbasan
1932

M b r e n d i j a

Vetveprimi i nxânësve	Faqe	1
Ço-u e vdekun	"	3
Provë mësimi — Gjuhë	"	6
Provë mësimi — Arithmetikë	"	8
Provë mësimi — Mësim jete	"	9
Provë mësimi — Gjuhë	"	11
Duhet të studjojmë shkrimtarët t' onë	"	13
Novelë — Dashuri që shpërblehet	"	15
Hartim — Rëndësija e madhe e rregullimit	"	18
Vjerrshë — Manushaqeja	"	20
Vjerrsha për shkollë — Durimi, Prindët, Bonjakja, Xixilloja.	"	21
Lajme të Shkollës	"	22
Qarkore	"	23
Probëma të mbledhura		

E përkohëshmjia "NORMALISTI", DEL NJI HERË NË MUEJ.

E botojnë nxânësit e Normales.

Editor:	H Ballshi	'32.	ndihmës	S Alliu	'33.
Sekretar:	L. Sh shmani	'32.	" "	Q Guranjaku	'33.
Arketar:	Y. Berisha	32.	" "	K. Jovani	'34.

Pajtimi: për gjashtë numra 2 Fr. ari
Nji numër kushton 2 Lekë.

Vetveprimi i nxânësvet edhe rândësija e 'tij.

Pedagogjija e re kërkon prej shkollës qi kjo të përpiqet me ua zhvillue vetveprimin nxânësvet. Pedagogë të përmendun në provat, qi kanë bâmë me individa të ndryshëm, kanë diktue se fëmija, përveç instinkteve të tjera, ka edhe instinktin e vetveprimit.

Fëmija i vogël pra ka mbrenda vehtes një farë energjije, qi e shtyn të bājë e të krijojë dishka vetë; kjo nuk është t'jetër veçse vetveprimi.

Këtë zotësi, qi kanë fëmijt, shofim se e shfaqin më tepër nëpër lojat e ndryshme tue krijuem gjithfarë gjânash me mendjen e 'tyne të vogël. P. sh. i shofim 'qi të ndërtojnë kasolla, shtëpija me gurë e baltë, me copa druni bājnë njerëz, të mbledhin gurë e t'i bājnë si bagëti e vetë të bāhen si barij, etj.

Shkurt pra fëmijt kanë një zotësi qi të krijojnë, t'i ndryshojnë e t'i personifikojnë gjanat.

Fëmija prish gjithnji një farë energjije për me krijuem e me bāmë dishka të mirë ose të keqe. Këtë farë zotësije, qi kanë këta për me krijuem në fillim gjāna pa qëllim, le të përpiqet shkolla, qi tā shtjerë në punë, kështu qi fëmijt të bāhen të zotët e të krijojnë gjāna me qëllim.

Nuk duhet pra t'ua shtypim e t'ua ndrydhim këtë instinkt të natyrshëm, qi kanë fëmijt; por përkundrazi duhet t'ua zhvillimë e t'ua drejtojmë.

Prej sa thanë kuptohet se vetveprimi i nxânësvet ka një rândësi të madhe për shtjellimin menduer e trupuer të fëmijvet e prandaj duhet të vihet në qerthëllim edhe nëpër shkollat t'ona. Vetveprimi mund t'u zhvillohet nxânësvet vetëm në shkollë në drejtim të mbarë tue përdorë për këtë punë landët e ndryshme të mësimit edhe gjithë mjetet e tjera. Mësuesi do të mund t'ia mbërrijë këtij qëllimi, në qoftë se do të jetë i zoti t'ia përshtasi çdo mësim natyrës fëminore. Me këtë mënyrë të gjitha landët e mësimit mund t'ua nxisin vetveprimin nxânësvet.

Mësuesi duhet të ketë para sysh gjithnji se ka të bājë me fëmijë, të cilët janë gjithë jetë e veprim e duen gjithnji të veprojnë

e jo të rrinë.

Mund t'ua zhvillojmë vetveprimin nxënësve tue i lanë këta në çdo mësim të kërkojnë, të gjykojnë e ta gjejnë çdo gjë vetë. Mësuesi duhet t'i nxisi të gjithë të veprojnë në mësim e jo vetëm disa.

Duhet të qiten nxënësit edhe përpara shokëvet, kur do të thonë ndonji gjë, si p. sh. në vjerrshë a në ndonji mësim tjetër, kështu qi të mësohen ata të flasin pa turp. Çdo shkollë duhet të ketë me doemos një kopësht, ku të punojnë nxënësit e të mbjellin gjithfarë lulesh e gjanash të bukra, të cilat do të hyjnë në punë edhe për mësimin intuitiv. Në këta kopështe nxiten nxënësit të punojnë e të veprojnë e, përveç kësaj, u hyn edhe një dëshirë e zell i mirë për punë.

Mësuesi duhet mandej të bëjë edhe shtetje në natyrë me fëmijë e duhet t'i udhëheqi këta, qi të vërejnë e të kërkojnë çdo gjë me kujdes. Po jo vetëm me anë të mësimi, mund t'ua nxisi mësuesi nxënësve vetveprimin; për këtë punë mund të përdoren edhe mjete të tjera.

Nji mjet i mirë është kur u ngarkojmë nxënësve ndonji punë të vogël; p. sh. qi të fshijnë dërrasën e zezë, të shikojnë pastërtin e dhomës ose ndonji punë tjetër, pse me këtë mënyrë do të mësohen nxënësit, qi të kujdesen për çdo punë e do t'u zhvillohet edhe ndjenja e përgjegjësisë. Çfaqjet e parallat dramatike fëmijore janë shumë të mira për me u zhvillue vetveprimin nxënësve; prandaj mësuesi duhet t'u mesojë nxënësve të ulla çfaqje e t'i çfaqin këto edhe përpara popullit. Këto më një anë i nxisin nxënësit të veprojnë, m' anë tjetër i mësojnë qi të mos kenë frikë e turp e i bëjnë qi të jenë më të qelët.

Më në fund, për me ia mbërijtë qëllimit të vetveprimi, duhet qi mësuesi çdo mësim ta bëjë si mbas parimevet të shkollës së punës. Kjo ka për qëllim më të parë qi prej çdo mësimi të mund të nxjerri mësuesi një farë pune, kështu qi të mund të veprojnë nxënësit. Mësuesi mandej duhet qi në çdo mësim të jetë si një udhëheqës i nxënësve; duhet vetëm gjënat e vështira t'ua kallëzojë dhe çdo gjë tjetër, qi mund ta gjejnë vetë ato, të mos ua dëftejë.

Shkollë pune e vërtetë quhet ajo, qi mund të shijerë në punë sa më tepër vetveprimin e nxënësve.

Për sa themë më nëalt kujtojmë se vetveprimi i nxënësve ka një rëndësi të madhe e sidomos këtu ke na, qi kemi shumë të meta në edukatën e shtëpis.

I. Leshtaj '32.

Ço-u e vdekun

Ço-u ah, ço-u, manushaqe e dashun Ngre-u shif natyrën pranverore, qi është tue qeshun me andje të madhe Çel-i syt dhe len-i të përpiqen me ata të mijt. Bân-i në gaz buzët e tua delikate, qi të shmallen Oh, tunde pak në të djathtë dhe në të majtë kokën t' ande të vogël, qi është e kunorëzueme me gjethet e kaltërta, për me më freskue pak valët e erës, qi bâhen prej të lëvizunit t' and Ço-u se rrezet e para të diellit po t' afrohen dhe duen të të përgëdhelin me dritën e tynë të hyjnueshme. Zgjo-u, mjaft fjetet; dita agoi, melodit e vashave po tingllojnë; zhurma po shtohet, zoqt po çajnë lehtë ajrin tue fluturue; jehona e kumbonave e mbushi natyrën Lulet e tjera, qi ke prânë, kanë pastrue për bukuri gjethet e tynë, e ti ende po flen!! Ço-u të lutem, se është turp . . . je e rë, manushaqe, dhe ende don të rrish e shtrime? Jazëk për Zotin

Me gjithë të thirrunat e mija aroma e manushaqes nuk më vinte. Atëhere nxorra kokën nga dritarja në kopësht dhe drejtova syt ke vendi, ku rritej manushaqja e ime e bukur.

— Ende i duket koha si pak e ftoftë, prandaj nuk po i qeshin buzët aq shpejt — thoshnja me vehte, kur nuk po e shifsha dot. —

U-mërzita mâ nga mungesa e manushaqes, jo pse nuk qeshte kësaj here, po pse nuk po e shifsha dot, prandaj çela derën e dhomës dhe u drejtova kah kopshti. I u-afruesh ferrave, qi ishin zbukuruem me trandafile, të cilët i përhapja disa më një anë e disa të tjerë m' anë t' jetër, edhe ngula syt tek fundi i ferrave të trandafilut, ku e dijshe sigurtë se rritesh manushaqja e ime. Pandejsnem se kësaj here ajo do të më tallte për padurimin t' em, por . . . ah, o Zot, . . . ç' të shifje?! . . . në vend të manushaqes s' ime të shtrejtë pashë një . . . gjarpën, qi ishte i mbështjellun si rripull

Ai ishte i zi si katrani, me sy të kuq, qi lëshojshin shkëndia zjarri, me gojë të madhe dhe të çelun, qi ishte gati me përpimë çdo kundërshtar; me dhambë të mpreftë si të tigrut; bishtin në majë nuk e kishte të hollë, por me një rruzull të mbuluem me

krenë gjarprijsh, qi derdhshin pa prâ në tokë një helm të kuq... Ishte i math, shumë i math; aman, o Zot, çfarë pamje të tmerrshme!!!... ai nuk ishte gjarpën i zakonshëm; vetëm prej së largu dukesh si gjarpën, por prej s' afërmi dukesh... një gjâ fare t' jetër... një gjâ me shpirt, por qi s' di si ta quej: gjarpën... drangue... a po...?

Për pak desh më ra të fikët, por u-përnabajta, mblodha pak vehten. — Jam burr — thashë me vehte — jam kafshë e arësyeshme, jam njeri, prandaj duhet ta zgjedh këtë mister... ç' u-bâ manushaqja? A thue se ai i paemni, gjarpni i jasht-zakonshëm, e ka përpimë? A thue se tash gjithë bukuria e saj venitet dhe po tretet në stomakun e asaj kafshe të paemën?

Desha t' i lutesha Zotit, por, kur po e shifsha përpara të paemnin, nuk gjejshe fjalë. Mâ në fund mblodha edhe mâ vehten t' ime dhe thirra: Zot, o Ti i Tânefuqishem, o... dhe mbeta, se gjarpni i tmerrshëm i drejtoi syt kah unë... Nuk i mjaftoi bukuria e jetëshkurtënës manushaqe dhe tash don të më përpjër edhe mue?... Po ç' ka, t' i flas një herë, kush e din mos më heth ndonji fjalë, mos më thotë dishka, U-mata të hap gojën, por gjarpni i zi filloi me ecë drejt meje... U-mata tash t' i bijsha me bastunin e trashë, qi kishja, por përsëri u-penduesh dhe bâna me qëndrue pa nxjerrun zâ fare...

— Ffshëëë, ffshëëë, ffshëëë — briti gjarpni dhe me një herë u-ndal. Po n' atë kohë duelën nga bishti i 'tij i rumbullakët të tjerë gjarpij, qi ishin mâ të vegjël dhe fare të ndryshëm e qi e rrethuen të paemnin;... unë u-tristova edhe mâ tepër. Tashti më dukesh se jeta e ime kishte mbarue. Pritshe qi të hidheshin mbi mue gjithë të paemnit dhe të më coptojsnin trupin fare tue mos më lënë asnji shenjë... dhe në këtë gjendje kaq të tmerrshme i bâna një lutje të nxehtë Zotit, jo me zâ, por me zemër... një lutje plot me fjalë të mallëngjyeshme, qi dilshin nga zemra e imë falkeqe... .

I paemni sikur u tha gjarpijve: Njeriu qi po na shikon nuk âsht për ne; manushaqes ia shkurtuem jetën, por edhe ajo nuk âsht për mbretënin t' onë;... kam çelun gjithë librat e mëkatave, por emnin e kësaj manushaqje nuk e kam gjetun... nuk âsht anëtare e jonë... Ajo do të pranohet ke xheneti, atje ku ne s' kemi asnji të drejtë... Na mendoj kot. Ejani

t' ikim tashti, se vijnë ushtërit e xhenetit për me e marrë shpirtin e kësaj anmiqeshe.

... Edhe me një herë të paemnit m' u-shdukën nga syt.. fërkova syt se mos isha n' ändër, por jo : isha në këmbë, përpara kam pasun ferrat e trandafilin dhe tokën të mbytur në helm të kuq edhe përpara këtij misteri fillova të përkujdesem, qi ta gjejshem manushaqen t' ime .. Hodha syt rreth e përqark dhe atje në një çip të ferrës pashë një rrasë; u-afruesh pranë dhe me dorën t' ime, qi dridhesh si purtekë, lëvizta pak rrasën dhe ja m' u-duk manushaqja ... Por nuk ishte e gjallë ... ajo ishte shtrimë për tokë e venitur; nuk shkëlqente më. Koka e 'saj tashti kishte puthur tokën; gjetheve u kishte dalë ngjyra e kaltërt dhe vendin e 'saj e kishte zënë një ngjyrë e verdhë si dylli; trupi i 'saj, qi ishte i drejtë dhe i shëndoshë, tashti jepte pamjen e njëj fije bari të thatë I kishte mbyllur syt përgjithmonë.

Nuk kam me e pamë më atë; bukuria e 'saj iku ... , por shpirti ku gjindet? Rrasën kush ia vuni përsipër? Mos e kanë bërë këtë të paemnit, me qëllim qi të mos e gjejshja unë e kështu të shkrihesha pak nga pak për bukurinë e 'saj dhe për humbjen e misterëshme?

.....

Erdha me të pamë dhe me të shijue bukurinë t' ânde, o manushaqe e ime, por të gjeta të venitur, të thame dhe të shëmtueme!! Ngre-u të lutem të të shof edhe një herë tue qeshun; ço-u, se due edhe një herë të të pushtoj në gjinin t' em; eja se due me e shijue edhe një herë kohën e lumtur Po ç' ke? Pse nuk më flet? Nuk mund të flasish nga mallëngjimi, se po të lutem dhe se po të due kaq shumë a po zani i yt i këndëshëm është përhapun nëpër shtresat e dheut?

E dij qi ti dëshiron me folë, por shpirti i yt ka dalë nga trupi e ka fluturue nalt në qiell Po këtu në këtë vorr do të tretet trupi i yt, qi ishte si qiparis? A këtu nën këtë dhë edhe nën këtë rrasë ka me u-venitur fytyra e jote sympathike? Ndoshta Por shpirti besoj se jo, sepse sjelljet e tua të mira, morali i yt i naltë dhe dashunia e madhe, qi ke pasun për çdo gjë, të kanë afrue pranë Zotit edhe ndoshta tashti je tue shtetitun nëpër kopshtet hyjnore të Parajsit e shoqënueme me Serafinet dhe me Kerubinet Po këtu në këtë tokë

mëkatore ke lënë një qi të dashunonte dhe qi e ke dashun fort. Ai po të vajton dhe po derdh lotë të nxehta mbi trupin t'ënd . . . Ti nashti atje shijon bukurin e hyjnueshme, e unë këtu po te vajtoj; ti ndoshta tashti je plot me gëzim, por zemra e ime është plot me vner, me hidhënie dhe me dëshpërime Me gjithë atë ti fluturove, por kujtimet e tua janë rranjosun thellë në zemrën t'ime dhe kanë me u-harrue bashkë me shdukjen t'ime prej kësaj bote

St. Spasse '32.

Provë mësimi

Dhënë për maturë në rendin e 1^{re} të Ushtrisë
mores.

Landa : Gjuhë.

Thema : Diktim. (Punët e bujkut në verë).

Rrjeshtimi i landës :

- a) Të formuemit e fjalivet.
- b) T'ushtraemit e 'tyne nga ana e nxânësvet.
- c) Të shkruemit nëpër rodhojt.

Paragatitja — Sikurse dihet, paragatitja hyn në punë, qi parafytyrimet e reja të mos hyjnë në shpirtin e fëmijës si të hueja e pa lidhje, por lipset të lidhen e të mbështeten në parafytyrimet e përparëshme, qi ka fitue ai në shtëpi, në shoqni e në shkollë. Dihet se çdo mësim mund të fillojë me gjithë farë paragatitjesh, por kujdesi më i parë i mësuesit është qi të gjejë një t'atillë paragatitje, qi mund t'u nxisi interesin e t'i bënë të padurueshëm për mësimin, qi ka me u-kallzue a qi ka me u-zhivillue. Porse, për me u-bamë një paragatitje e 'tillë, duhet ta ketë burimin në gjënat më t'afërme për shpirtin e fëmijës, si me thënë, në jetën praktike a në jetën e përditëshme të 'tij.

Për paragatitje në këtë mësim mund të përdorim edhe këtë : "Kush din me më kallzue prej jush se çfarë punësh bën bujku në verë ?" (Nx. . . .). Këtu lihen nxânësit, qi të përsërisin shkurt punët e bujkut, qi kanë mësue në mësimin e jetës : " **Punët e bujkut në verë.** "

Paraqitja. — Mbas pyetjes së sipërme, nxânësit kanë me dhënë përgjigje të ndryshme, por mësuasi duhet t'i drejtojë, atje ku është nevoja, edhe lenda të bëhet tue shkue si mbas rrjeshtimit, që ka bërë vetë natyra P. sh. më parë duhet të formohen fjali për barin, se barin bujku e kosit më parë; mandej për misrin, të cilin e prasit dhe e ujit në verë e më në fund për të korruarit e të lashtave, se këtë punë bujku e bën më vonë se të tjerat.

Ushtrimi. — Kur do të pyeten nxânësit se **ç'punë bân bujku në verë, atëhere ata ndoshta kanë me thënë se bujku në verë korr të lashtat.** Këtu duhet me iu thënë se me të vërtetë bujku në verë korr të lashtat, por, përpara se t'i korri të lashtat, ai merr një kosë në krah dhe vete në për livadhe. Çfarë thoni se bân ai me kosë në livadhe? (Nx. . . .) Nxiten nxânësit, që ta thonë më bukër: **Bujku në verë kosit barin.** Këtë fjali e thonë disa nxânës një nga një e mandej thohet horas. Mës. Mbassi e kosit barin bujku, a e len në livadh? (Nx. . . .) **Këtë, mbassi e kosit, e ven në mullar.** Kjo fjali thohet prej disa nxânësve e mandej thohet horas. Mës: në verë ka mbimë misri; bujku tashit merr një shtat edhe vete të ara e misrit; çfarë bân ai atje? (Nx: Ai prashit misrin. Mës: në verë është vapë e madhe, prandaj arat e misrit thahen, por bujku, që të mos thahen, u bân dishka t'jetër; çfarë thoni ju se u bân? (Nx. . .) kush do ta thotë më bukur, se çfarë i bân bujku misrit? (Nx. . .) **Ai në verë prashit dhe ujit misrin.** Mës: mbassi e kosit barin dhe mbassi e prashit dhe e ujit misrin bujku, a nuk punon më? (Nx. . .) në verë bujku çfarë iu bân të lashtave? (Nx. . .) **Bujku në verë korr të lashtat.** Edhe kjo fjali thohet prej disave një nga një e mbandej horas. Mës: Mbassi i korr të lashtat, ku i çon ato? (Nx. . . .) Këto i çon në lëmë. Po çfarë bân atje? (Nx. . .) I shën me kuaj. Mës: kush do ta thotë më bukur? (**Këto i çon në lëmë dhe atje i shën me kuaj.**) Thohet një nga një prej disa nxânësve e mandej horas. Mës: Shifni pra se sa punon bujku i shkretë; ai mbjell, kosit, korr, prashit, etj. me sa fuqi që ka, si thoni pra për këto punë, që bân bujku, a duhet ta duem e ta nderojmë? (**Ne duhet ta duem e ta nderojmë**

shum bujkun. se ai punon gjithë ditën.) (Thohet horas,)

Mbassi ushtrohen të gjitha fjalit, atëhere u thohet nxân. se këto kemi me i shkruie nëpër radhoj. për mos me i harrue. I nxjerrin nx. radhojt me rregull (1. 2, 3). Pendët nali! Trupin drejt! Mandej më. fillon me ua kallzue fjalin e parë tue i thek-sue e tue i dallue mirë fjalët njanën nga tjetra; të flitet ngadalë edhe kurrë të mos përsëritet një fjalë dy herë, se nxân., tue e kujtue për tjetër fjalë, e shkruiejnë dy herë. Kur mbarohet fjalija, u thohet se mbas pikës me çfarë shkroje duhet fillue, etj.

Tabela e mësimit

Bujku në verë kosit barin. Këtë, mbassi e kosit, e ven në mullar. Bujku në verë prashit dhe ujit misrin. Ai korr të lashtat. Këto i çon në lëmë dhe i shîn me kuaj. Ne duhet ta duem e ta nderojmë shumë bujkun, se punon gjithë ditën.

St. Spase '32

Provë mësimi

Dhânun për maturë

Në rendin e II^{te} të Shk. Ushtrimore

Landa : Arithmetikë.

Thema : Problema të ndryshme : të shumzuemit e dhet-shavet të përziemë.

Z h v i l l i m .

Landa e arithmetikës duhet me u-nxjerrë kurdoherë prej mësimit të jetës; prandaj pra edhe ky mësim ka me u-nxjerrun prej mësimit të jetës, qi ka me u-bâmun n'orën e parë. Si hyrje përdorëm këtë: pyeten nxânsit se kush prej 'tyne ka kopësht ke shtëpija e vet e, si të shifet se kush ka prej 'tyne, pyetet ndonjëni se çfarë ka mbjellë në kopshin e vet. Në këtë mënyrë tregohen bimët që mbillen, si lule, pemë, perime, etj.

Tash, për të fillue paraqitjen, u thohet nxânësve se në një kopësht janë 4 rrjeshtë lulësh, nga 12 rrânjë secila rrjeshtë; pra pyetet nx. sa rrâjë lule ka n'atë kopësht. Mës. shkruen në Dërrasë 4×12 e derisa ta shkruiejë u lë kohë nx. për të mendue. Si të marrë prej 'tyne përgjegjen ($4 \times 12 = 48$), i kërkon

nx. pshin; pra arsyetohet prej nx. kështu : $4 \times 10 = 40$ edhe $4 \times 2 = 8$; $40 - 8 = 48$; pra $4 \times 12 = 48$. U thohet nx. me nxjerrë fletoret e urdhunohen qi ta shkruajnë atë qi është shkruar në dërrasë (Në të shkruem e sipër, mës. endet nëpër bânkat dhe kqyr nx.). Si ta kenë shkruar, u thotë se n'atë kopësht janë mbjellë 3 rrjeshta pemë, nga 11 druj sejcila rrjeshtë; pra sa druj pemësh ka n'atë kopësht. E shkruen edhe këtë në dërrasë e, kur ta ketë mbarue së shkruemi, nx. janë në gjendje për t' u-përgjegjë; kërkohet përgjegjja dhe arsyeja prej njanit; mbas përgjegjes së nxânsit e shkruen mësuesi në dërrasë e po n'atë kohë che nx. nëpër fletoret e t'yne.

Po në këtë menyrë bëhen edhe problema të tjera si : 6×13 , 5×14 , 7×13 ; 3×25 . 2×34 , 4×32 , 3×29 , 4×27 . Por kto të gjitha, sikurse të parat, duhet të bëhen konkrete; në qoftë se ndonjëna prej ktyne është e vështirë, nxirret ndonji nga nxânsit, qi ta bëjë shumimin në dërrasë.

Për me e mbyllun këtë mësim me interes, nj'a 10 minutat e fundit dâhen nx. dysh dhe njâna ânë i flet ânës t'jetër problema Kështu qi nx. do të vetveprojnë edhe mâ shum, e vetvetiu do të dali interesi. Porse këtu duhet me pasë kujdes këtë gjâ : fëmijët i flasin njâni t'jetrit problema, qi mund të jenë të vështira, se edhe ai qi e flet nuk din ta bëjë, por e flet ate problemë vetëm e vetëm pse do që ta mundi shokun (kundër-shtarin); prandaj duhet me i porositë se, ai qi pyet shokun për nji problemë, mâ parë duhet ta dijë vetë.

Tabella e mësimit

$4 \times 12 = 48$	$4 \times 25 = 100$
$3 \times 11 = 33$	$2 \times 34 = 68$
$6 \times 13 = 78$	$4 \times 22 = 88$
$5 \times 14 = 70$	$3 \times 29 = 87$
$7 \times 13 = 91$	$4 \times 27 = 108$

M. Kadilliu '32.

Provë mësimi

dhânun për maturë në rendin e III^{të} t' Ushtrimores.

Landa : Mësim jete.

Thema : Panajiri i Shingjonit (bashkë me gojdhânën e të Shejtit).

Paragatitja. — Si hyrje për këtë mësim përveç të tjerave mund të vlejë edhe kjo : Nxiten fëmijt tue i u treguem se 3 a

4 ditë përpara tue ardhë nga Namazgjaja, pashë një shumicë njerzish, kol, gomar, mushka, lopë, etj. U-çudita prej gjithë atyne kafshëve. qi ishin mbështjellë aty si miza në drutë. A e dini ju pse ishin mbështjellun gjithë ato kafshë aty? Nx: kanë ardhë për t'u-shitun se është Shingjon Mës: Pra edhe ne sot do të flasim për Shingjonin. Me këtë të fundit del qëllimi i mësimin.

Paraqitja — 1) Fillimi i Shingjonit.

2) Për gjat qi mbështillen, për shitjen, blerjen e tramtat; pastaj për mënyrën e shitjes e të blemes, për mënyrën e të njoftunit, për taksat e më në fund për njerzit, qi kryejnë maradhanjet e shitjes së këtyne kafshëve.

3.) Për mënyrën e të festuemit të kësaj feste.

4.) Për gojzhanën e të Shejtit.

5.) Për ekonomin e vendit.

Mbasandaj pyeten nx : Ç farë dite ka filluem Shingjoni ? Nx : Shingjoni filloi ditën e Shtunë. Pastaj me anë të pyetunash të tjera del fjalija : Shingjoni fillon më 4 Qershuer. Kjo fjali, si thohet prej disave, filltet horas. Në këtë kohë pyetem prap nx : se ç kanë pamua për Shingjon (ktu lihen të lirë të tregojnë nx : vetë) Mës : Të gjithë ata njerës qi keni pamë ju vetëm për të shitun vijnë ? Nx : (edhe për të blemë e për të bënë tramta). A ka pamë ndonji prej jush se çfarë bënë ai burri para se të blejë një kafshë ? (Nx, kallzojnë mënyrën e të blemit dhe të të njoftunit, tue u-nxiti prej mësuesit). Kështu pra, mbassi e pëlqen edhe i ep paret të zotit të kafshës, e çon ke itisapçiu për të pague taksën. Jo vetëm kur blejnë e shesin paguejnë taksë, por edhe kur i ndërrojnë ose bëjnë tramta. Por ata, qi bëjnë më tepër tramta, janë arixhijt, disa njerës, qi vijnë këtu mot për mot, kur afrohet Shingjoni. Disa prej këtyne janë njerës të këqij, pse i rrejnjë katundarët e ia mbushin mendjen, qi të blejnë a të ndërrojnë një kafshë, me gjithë qi ajo është e keqe e nuk bënë fare. (Këtu nxiten nxansit, qi të kallzojnë se si bëjnë arixhijt, kur duen t'ia mbushin mendjen ndonji njeriu)

Mbasandaj u thohet se në çfarë vendi t'jetër mbliidhen njerës për të festue ditën e Shingjonit. Natyrisht femijt do t' i përgjigjen qëllimit të pyetjes tue treguem se shkojnë e mbliidhen në Shingjon. Si të dali prej gojës së nxansvet Shingjoni, atëhere lihen qi të flasin vetë mbi ceremonin e atjeshme e të kallzojnë

se qysh përgatiten njerzit për të shkuem atje, ç'bâhet në kishë, qysh del Shejti, ç'bajnë njerzit, etj. Tue dashtë me i treguem fëmijet se këto lutje e ceromoni bâhen për nder të një njeriu, qi ka vdekun aty, iu dëftohet, si kallzim nga ana e mësuesit edhe gojdhana e njoftun për atë njeri. Kështu zë e tregon mësuesi gojdhana: Shingjoni ka qenë mbret i Sërbis edhe një burrë i dashun e i mirë. Kur ishte gjallë, pat hymun në luftë me mbretin e Bullgaris, i cili, si i pushtoi vendin, e zûni të gjallë, i preu kryet edhe e hudhi afër një pyelli, qi ta hanë bishat e egra. Mirpo njerzit e muerën dhe e vorruen në kishën e Shin Naunit, një vend kundrejt Pogradecit. Mbreti i Bullgaris këtij i kishte marrë shumë mëni edhe, si pushtoi Shin Naunin, ia nxuerr rreshtat edhe ia hudhi. Por prap njerzit e vet e muerën dhe e çuen në Tivar. Këtu ndejti Shingjoni afër 200 vjet. Në krye të ksaj kohje e nxuerrën atë prap prej Tivari edhe e prunë në Shingjoni t'onë, mbassi këtu nuk mur d ta luejshin më anmijt. Qysh prej asaj kohe Shingjoni, i quejtun Johan Viladimir, ka zânë vend ketu ke në. Mot për mot pra festohet dita e kuj prej popullit t' Elbasanit edhe, por sa qitet ky prej kishë, fillon edhe Shinjoni këtu n' Elbasan.

Përdorimi e ushtrimi qëndron këtu në të kallzuemit shkurt e shkurt të gjanavet të mësueme.

Shënim : Kjo temë i përshtatet shumë venit të lindjes, nga shkaku se Shingjoni është një festë lokale e Elbasanit; prandaj, sa herë të qëllojë një ksisoj teme, është mirë qi të bâhet, se nxânsit kanë se ku të kapen e do të mësojnë më me interes.

Kamer Osmani '32.

Provë mësimi

Dhënë për maturë në rendin e IV të t'Ushtrimores.

Landa : Gjuhë

Thema : Fjalë shëmbullore e ushtrime të të foluni tue formuem fjalë të përbâme.

Zhvillim

Mësimi do të lidhet me mësimin e jetës, të lashtat, e prej këtij do të nxirret lenda e kësaj ore. Për këtë pyeten nxânsit : Kush do të më tregojë prej jush çfarë korr bujku në këtë kohë ?

Nx: bujku tashti korr **të lashtat**. Merret vetëm fjala **të lashtat** e, mbassi të thohet prej disa nxânësve një nga një e të flitet horas, shkruhet prej 'tyne në radhojt e prej mësuesit në dërrasë të zezë. Si të jetë shkruem kjo, urdhnohen nxânësit, qi të numërojnë farët e të lashtavet, e, mbassi të thohen këto prej dy a tre nxânësve, shkruhen drejt për së drejti pa u-folë horas, mbassi janë fjalë të lehta për këtë rend. Tue i pyetun nxânësit se si i themi ne kësaj kohe, qi korren të lashtat, do të dali fjala **të korrat**, e cila, mbassi t'ushtrohet, do të shkruhet prej nxânësve në radhojt e prej mësuesit në dërrasë. Mbasandaj dalim ke veglat e korrjes si ke drapni e ke kosa. Edhe këto do të gjinden prej nxânësve me anë të pyetunash; do t'ushtrohen e do të shkruhen. Do të flitet se si i korr bujku të lashtat (këtu mund të bëhet ndonji ushtrim ruthmik) e do të nxirret fjala **duej**, e cila do të shkruhet sikurse të parat. Mbasandaj pyeten nxânësit se ku i çon bujku duejt; nga kjo kështu do të dali fjala **lâmë-a**, e cila do t'ushtrohet e do të shkruhet. Me anë të pyetunash e, në formë bisedimi nxirren, ushtrohen e shkruhen edhe këto fjalë: **të shimit, kallini, kashta, byku, hala, krundet, miell No 1, miell No 2, miell No 0, miell Trieshte**. Bisedohet me nxânësit për llojtë e ndryshme të miellit, përse quhen ashtu e më fort për miellin e Trieshtës.

Si të mbarohen fjalët së shkruemi, e si të kënë mbyllun nxânësit radhojt, atëhere, për me iu dhënë atyne një kuptim të fjalëveve qi u-mësuen e për me i ushtrohe në të folun, dalim prej kuptimit të njëj fjalë në një kuptim tjetër; prej njëj fjalije të thjeshtë në një të ndërliqme. P. sh. qi të mësojnë nxânësit se fjala **të lashta** përdoret për me kallzuen edhe gjana të tjera, u sillen atyneve shembuj ose nxiten, qi të gjejë vetë se ku përdoret më ajo fjalë, si **njeri i lashtë, fik i lashtë**, (kohna të lashta, të vjetra etj) edhe fjala të korrunit këthehet e bëhet **e korrma**; i jepet kuptimi **më korri uni** (më sharroi uni), etj; po kështu flitet edhe për fjalën **lâmë**. E bëni **lâmë Dhimitri, d. m. th. e derdhi**, etj. Edhe fjala **kalli** çohet në kuptimet e 'saj, si mbeta kalli (mbeta fill i vetëm), etj. Kështu veprohet edhe për fjalët e tjera tue treguem rasët e ndryshme, në të cilat përdoret një fjalë. Mbas klij veprimi formohen fjali të ndryshme. Mës: Kush prej jush do të bëjë një fjali me fjalën e parë **të lashtat**?

Nx : Të lashtat mbillen në vjeshtë. Si të dali kjo fjali, u thohet nxânësve ta shtojnë edhe më, si **të lashtat mbillen në vjeshtë e, mbassi piqen, korren në verë.** Merrret mandej fjala gruni e formohet fjallija : **gruni është një e lashtë kryesore;** mandej e shtojmë edhe më e bëjmë këtë fjali : **prej grunit, qi është një e lashtë kryesore, nxjerrim miellin, të cilin e bëjmë bukë.** Po kështu merren edhe disa fjalë të tjera e formohen prej 'tyne fjali të thjeshta e të përbëme, veçse duhet kujdes qi këto t'ushtrohen mirë e të kuptojnë nxânësit formimin e 'tyne. Ky ushtrim të foluni më fjali të përbëme ka rëndësi, pse mësohen nxânësit qi t'i lidhin mendimet e 'tyne mirë e bukur e të bëhen gadi për hartime të mirëfillta.

Tabela e mësimi

Të lashtat: gruni, elbi, tërshana, thekna, tepa.

Të korrat: drapni, kosa, duejt, lâma, të shimit, kallini, çfurku, kashta, byku, hala, miell No 1, miell No 2, miell No 0, miell Trieshte

N. Babameto '32.

Duhet të studjojmë shkrimtarët t' onë.

Asht për t' u-vumë re se na Shqiptarët s' e kemi në thue artin e të shkruemit. Shkrimet t' ona janë të hallakatuna; mendimet t' ona përplasen pa rregullë sa në një vend aqë edhe në t' jetrin të faqes së njëj letrë. Rrallë gjinden njerzit, qi shkruajnë e qi shkrimet e 'tyne janë të vlefshme, të llogjikshme e të këndëshme. Gjithë kjo e metë, qi na shtyn mbrapa qytetnimit, vjen, nga se ne nuk e tëholiojmë mëndjen dhe gjykimin t' onë, tue kënduem libra. Letërsija është ajo, qi na thotë me të madhe ta bëjmë këtë punë. Stili i mirë, shfaqëja e mendimevet, ashtu si duhet, fitohet vetëm tue studjuem ata, qi kanë shkruem bukur; ata qi kanë një stil të mirë. Këta janë shkrimtarët; emën të cilin ua jep letërsija e qi do më thënë "**mjeshtër të shkrimit**". Po a kemi ne shkrimtarë, a kemi ne mjeshtër të shkrimit? Kësaj pyetjeje do t' i përgjigjem po. Edhe ne kemi shkrimtarë, porse këta në krahsim me ata të shteteve të tjerë, janë porsì një bülë

ujë në mes të detit. Po a i dimë na cilët i në këta shkrimtarë të pakë? Tue mos marrë para sysh përjashtime, po gërgjigiem jo. Askundi t'jetër, veçse në disa shkolla të mesme e shumë, shumë ke disa dashamirë të gjuhës, nuk njihet Naim Frashëri, At Fishta, Kristoforidhi, De Rada, Bozuku, Prendushi, Bogdani, Asdreni, Çajupi e të tjerë. Kjo vjen, nga se ne nuk kemi kënduem shkrimet e 'tyne. Ai, qi s'këndon të paktit, s'këndon as të shumtit, prandaj mos të qahemi se s'kemi shkrimtarë, duhet t'ia hedhim fajin vehtes e të themi: **s'jemi të zott të këndojmë**. Kësaj plogëtije duhet t'i largohemi. Për me pasanuem letërsin t'onë, duhet t'iu vihemi studimeve të shkrimtarve t'onë e mbasandaj ata, qi dijnë ndonji gjuhë të huej, t'i vihen studimit të shkrimtarve t'atij vendi. Nji gjã, qi s'e kemi pamë a ndigjuem, s'e mesojmë dot; kështu edhe arti i të shkruemit nuk fitohet pa kënduem. Në shkrimet e shkrimtarvet t'onë do të gjejmë përdorimin e drejtë të gjuhës; do të kuptojmë ç'është proza dhe poezija; do të marrim vesh kur flet arsyeja e fandazija; do të mësojmë përdorimin e drejtë të figurave, pastërtin, veçanin dhe armonin e gjuhës e gjithazi mëveshjen e bukur qi i jep nji shkrimtar mendimit të vet.

Nga lindja e Skëndërbeut, gjër në ditet që u-martua, rreth diellit lëmshë dheut dyzetë herë u-rrotullua, thotë Naim Frashëri. Kjo frazë e shumë të tjera si kjo të Naimit na japin të kuptojmë se sa larg i merite fjalët (landën) poeti i ynë i math.

At Fishta thotë: "Ai është zënë Abdullah Dreni, nj' ai pa t'cilin s'hecë kuvendi"; "Uh! Europë, ti kurva e motit, qi i rae mohit besës se Zotit", etj. Këto frazë e gjithë të tjerat, qi gjinden ç'prej fillimit e deri në mbarim të çdo vepre të tij, na japin intuita të plota të përdorimit të figurave e përgjithnisht të nji shkrimi të bukur.

Kristoforidhi, baba i gjuhës, na jep lehtësi të madhe në punë të të shkruemit; në veprat e 'tij do të gjejmë thesarin e gjuhës s'onë.

Bozuku me shkrimet e 'tij na ka lënë trashigim gjuhën e vjetër. Po të merremi me këtë e me të tjerë, shkrimtarë të vjetër kemi me nxjerrë në shesh rranjët e gjuhës. Sqiroi, Asdreni, Çajupi, Prendushi e të tjerë shkruajnë aqë bukur, sa qi nga

studimi i 'tynë përfundon me një dije të mirë dhe me një kënaqsi të shpirtit. Ja pra paskemi edhe ne shkrimtarë; paskemi edhe ne ku të mbështetemi; paskemi ku me i kullotun syt, me e ushqy m mendjen e me fituem mjeshtërin e të shkruemit, vetëm se na mungon **vullneti i fortë dhe dëshira e madhe.**

Popujt e huej i mbajnë librat e shkrimtarve ndën kryej edhe kur flejnë. Ke ata edhe bujku, mbassi le parmendën, zbatimet tue kënduem. Ke na ketë punë s' mund ta bëjnë të gjithë, sepse cipa e zezë e padijes na ka mbuluem, po thue prej koke deri në këmbë. Këtë punë duhet ta bëjmë na, qi kemi pamë dritën e arsimit; na duhet të studjojmë me qejf shkrimtarët t' onë Titullin intelektual qi me gabim ia ngjisim vehtes, vetëm atëhere e meritojmë, kur të jemi të zotët e pendës e të mendimevet të nalta. Kjo fitohet me studim. Tue studjuem do të bëhemi **mjeshtër të shkrimit** dhe do të punojmë **Letërsin t' onë Kombëtare.**

Të huejt vetëm atëhere do të thonë u lumtë shqiptarve, kur na t' i përvishejmë me mish e shpirt kësaj pune e të bëhemi me kuptimin e vërtet të fjalës **njerës të kulturuem.**

H. Ballshi '32.

Novelë

Dashuri që shpërblehet

Në një mëngjes prandvere kisha dalë për të shëtitur nga udha e Qishës me mikun, që më kishte thirrur në fshatin e 'tij për të shkuar atje disa ditë.

— Më fal! Ç'vështron? — i thashë.

Ai, duke ecur, shikonte andej e kënde, sikur donte të hetonte gjë në mes të varreve të Qishës, q'ishim duke shkuar.

— Ç ke? — e pyeta. Më bëri me shënjë të heshtja dhe pastaj, pas ca hapave, më tha:

— Ka ikur... Eja kënde.

Hymë mbrënda në vorrezat e Qishës dhe arritëm në një varr, i cili mbi krye kishte një kryq të drunjtë me këtë emër: "Nikë Gjini..."; sipër 'tij ishin hedhur shumë manushaqe të përhapura mbi 'të.

— Ç'është ky varr? — pyeta mikun.

Është një histori e vogël e fshatit t'onë —

Dëshiron të ta kallztoj? Dëgjo. —

Ndëjta dhe miku fillojti të më rrëfejë historinë:

“Zonjusha Anë Doti me të qëlluar e kishte njohur djaloshin Nikë Gjini, që gjëndet i varrosur këtu Një ditë, kur zonjusha Anë vinte me prindërit e 'saj në vilën e 'tyre, që ndodhet këtu pranë, për të gëzuar bukuritë e pranverës, qe natyra i ka falur fshatit t'onë, kuajt e karrocës, mbi të cilën kishin hypur, qenë egërsuar kaqë sa karrocieri nuk mundte dot t'i përmbante. Udhë ishte e keqe dhe nga njera an e 'saj ishte një hendek i thellë; kështu që qenë në rrezik të math të binin të gjithë. Pa pandehur Niko Gjini doli në mes të rrugës dhe me rrezik të jetës së 'tij zuri kuajt nga frëri dhe mundi t'i mbajë —

“Zoti e zonja Doti si edhe vajza e 'tyre zbritën nga karroca dhe e falënderuan Nikën për ndihmën e 'tij të papritur. Kjo është njohja e parë e Anës me Nikën. —

“Ana ishte një vajzë shumë e bukur, njëzet vjeçare, vajzë e vetëme dhe trashëgimtare e një pasurije të madhe, prandaj nuk kishin munguar shumë të rinj t'i kërkonin dorën. Por zonjusha Anë nuk dëftente ndonjë shtërngim për martesë. Romantike prej natyre i urrente martesat, që bëhen për fitim dhe ëndërronte dashuri të vërtetë e të nxehtë, si ato qi kishte kënduar nëpër romancat. —

“Sa për Nikë Gjinin, ky ishte djali i një tregëtarit të fshatit, të cilin nga shkaku i shëndetit e kishin këshilluar mjekët t'i priste studimet. Thonë se dashurija lint me një të parë të rinjë të jetë e vërtetë, pse, që atë ditë që u takua Nika me Anën, u-këthye në shtëpi i goditur prej syrit të zi të 'saj dhe një dashuri fatale u-lint në shpirtin e 'tij. —

“Në ditën e parë të Majit në vilën Doti-u-bë një ziafet me rastin e ditëlindjes s'Anës. Ishin ftuar dhe shumë të rinj, midis të cilëve prindërit e Anës shpresonin se ajo do të zgjidhte të shoqin që i pëlqente. Kishin ftuar edhe Nikën; ky, kur vate, shpuri me vehte dhe një tufë manushaqesh.

— Sa të bukura janë këto manushaqe! — tha Ana, kur i pa. Sa i dua unë manushaqet...

“Nika nuk i u-përgjegj fare e tërë atë natërrinte i mejtuar

dhe iku më parë nga të gjithë. —

“ Ditën t'jatër në mëngjes shërbëtorja i dha Anës një tufë të madhe me manushaqe. —

— E sollnë për juve, zonjushë. i tha Anës. —

— Kush e pruri? e pyeti vajza. —

— Një djal i vogël.

— Kush e dërgoi?

— Nuk tha gjë.

“ Ana i mori manushaqet e iu mori erë. Kush vallë—tha i dërgoiti e fshihet prapa këtyre?!

“ Ditën t'jatër, po ai djal, solli një tufë t'jatër me manushaqe. Këtë herë ia mori djalit vetë Ana dhe e pyeti:

— Kush të dërgoiti?

— Nuk di.

— Është i vogël? i math?

— Nuk di.

— Ku rri?

— Nuk e di.

“ Kuptohesh se atë djal e kishin porositur të thoshte ashtu e të mos kallzonte dërgonjësën e manushaqeve. —

“ Çdo mëngjes, po ai djal, çfaqesh në vilë me një tufë manushaqe. Një ditë Ana u-zëmërua dhe e porositi shërbëtoreshën të mos të pranonte prapë tufën me manushaqe. Djali me gjithë këtë i la manushaqet tek porta e iku. —

“ Ishte një mister, që fshihesh prapa dërgatës së manushaqeve e që shpirti romantik i Anës çuditej. —

“ Shumë herë, duke iu marrë erë manushaqeve të të panjohurit, Ana mbyllte syte dhe linte fandazin të kulloste për të gjetur dërgonjësën e vërtetë të tyre. —

“ Por jo, se dërgonjësi i manushaqeve nuk i ishte i panjohur Anës dhe ky nuk që njeri t'jatër veçse Nika, simpathiku Nikë, me ata sy të shkëlqyer e me atë fytyrë të zbetë. . . . Ai i kishte prurë për të parën herë një tufë manushaqesh.



“ Kështu shkoi viti, kur erdhi përsëri pranvera, një ditë po ai djalë u-çfaq në vilën me një tufë manushaqesh: “ Për zonjushën Anë . . . Kur e mori tufën e parë me manushaqe, dy

lotë i u-derdhë në fytyrë. Çdo mëngjes djali i vogël sillte rregullisht nga një tufë të madhe me manushaqe, gjersa një ditë nuk u-duk më. As ditën t'jetër nuk erdhi! Anën u'ato dy ditë e kishte pushtuar melankolia. —

“Pse u-pre kështu me një herë dërgimi i manushaqeve?”

“Natën t'jetër një i ardhun i tha zotit Doti:

— Mësuat për Nikë Gjinin, për atë që ju kishte shpëtuar nga rreziku? Vdiq dje në mëngjes. —

— Si? Vdiq? pyeti zoti Doti. Ai i mjeri, kaqë i ri

— Nuk qe mirë nga shendeti. Pastaj, si duket, do të ketë qenë në mes edhe ndonjë punë dashurije. . . . Ndonji maraz i fshehët. Dje u-bë edhe varrimi i 'tij. E vetmja gjë, që kërkojti, ishte ia mbulonin trupin e 'tij me manushaqe. —

“Ana u-zverth nga fytyra, me të dëgjuar këto fjalë. Tashni e mësojti me siguri se kush ia dërgonte manushaqet dhe shkaku e mosdërgimit më. Vuri duart në kokë dhe ra e fikët për dhë.



“Kanë shkuar që atëhere plot dhjetë vjet. Ana mbeti e pamartuar. Çdo pranverë vjen këtu dhe çdo mëngjes heth mbi këtë varr shumë manushaqe. Të gjithë këtu në fshat e dinë këtë histori të vogël dhe kur, nga lark, e shikojnë Anën, që rri te ky varr, e ndrojnë udhën, që mos ta çqetesojnë në dhënie e shpërblimit. —

“Ana ia kthen dashurin Nikës po n'atë mënyrë, që ia çfaqte ai, kur qe gjallë: me tufa manushaqesh „

Vangjel Nasto, '30.

Hartime nxânësish

Rândësija e madhe e rregullimit në jetën e veçantë e në jetën e përbashkët.

Për me kuptuem vlerën e rândësin e madhe, qi ka rregullimi më përpara duhet të dijmë se ç' domethane ka.

Të kesh rregullim, d. m. th, me e bëmë çdo gjë në kohën

e vet, me qenë i përpikët nga çdo pikpantje, të kesh para sysh një farë udhe, mbas së cilës do të shikojsh. E ku ka gjã mã të mirë se kjo? Ku ka gjã mã të mirë se një rrojtje e rregullshme? Si mund ta marrim me mend një njeri, qi s'ka një farë mase e një farë sisteme në jetën e vet? Rrojtja e 'tij do t' ishte fare e shkatërrueme, nuk do të kishte pikë vlerë e bile nuk do të qëndronte në kambë; jefta e 'tij nuk do të krahasohesh as me atë të kafshëvevet, të mizavet e të bimvet, pse edhe kto të gjitha kanë një rregull në jetesën e 'tyne.

Kuptohet fare mirë se një njeri pa rregull është edhe pa dituni, pse, po ta gjykojmë punën mirë, edhe kjo është e mbështetur në një masë e në një sistemë.

Qysh mund t'i marrim me mend pra njerzit e popujt, qi nuk kanë rregullim në vehtën e 'tyne? Duhet ta dijim fare mirë se do t'iu përgjajshin disa druve trupshtrëmbëta, do t'iu përgjajshin disa pemve, kokrrat e të cilavet janë të kalbëra, t'idhta e të krymbëta.

Nuk ka gjã mã të rëndësishme se rregulla; kjo është themeli i çdo gjãje: është themeli i botës, i jetës së njeriut, është baza e çdo krijese, qi qëndron në kambë në këtë botë.

Mendja e njeriut është gjithë rregull e gjithë sistemë; organet, e 'tij janë ndërtoem si duhet e bëjnë secili punën e vet. Mirë pra, kur njeriu, qi është një krijesë e natyrës, paska në jetën e 'tij të mbrendëshme një rregullim kaq të math, po natyra vetë e cila i ka dhanë shpirt çdo gjãje? Vetvetiu kuptohet se edhe kjo është e mbështetur në rregulla e udhëhiqet prej këtyneve. Porsi zemreku, i cili vë në lëvizje veglat e orës e i bën qi të punojnë, një ashtu vë edhe rregulla botën në lëvizje e e bën qi të qëndrojë në kambë, e,

„dersa rregull mos të ketë,

S' do t' qëndrojë asgjã mbi dhëtë „.

Ta parafytyrojmë një herë me mendjen t'onë një njeri, qi nuk ka një masë e një sistemë, pale qysh do t' ishte!... Le qi nuk mund të rronte, por, edhe në qoftë se rronte, do t' ishte porsi një automobil pa timon, pse zemreka e timoni i jetës së njeriut është rregulla; pa këtë ky do t' ishte si një pupël, të cilën e merr era dhe e çon nga të dojë; do të gjindesh në mëshirën e dallgëvet dhe furtunavet të jetës e nuk do të mundte me u

bâmë ball këtyneve aspak.

Po kështu vete puna edhe për aji komb. Nji shtet, qi s'ka rregull, a mund të qëndrojë në kambë? Mâ sa qëndron nji shtëpi me rreshtuna zoqsh, aqë do të qëndrojë edhe ky.

Le t'i sjellim ndër mend të gjithë ata popuj, qi s'kanë pasun rregull e të shofim se ç'kanë pësue!... Janë dergjun gjithëmonë n' errsinën e padijes, janë bâmë vegla e tjetrit, e zgjedha e të huejit ua ka rânduem gjithëmonë qafën. S'ka ku të vejë mâ keq për nji popull, qi s'ka rregullin në vetvehte! Ai i përngjan një shtëpije pa themel, nji lisi qi i u-kanë brejtun rrajët e qi s'do gjâ t'jetër veçse nji furtunë, e cila ta rrokullejë përdhë.

Nga të gjitha këto qi thamë, kuptohet fare mirë se shpirti i çdo gjaje në botë qenka rregulla, pse në këtë qëndroka e u-mbështetka çdo gjâ.

Edhe na pra, në qoftë se duem të rojmë mirë në botë, në qoftë se duem të bëhemi me të vërtetë njerës me kuptimin e plotë të fjalës, duhet të kemi nji masë e nji sistemë në punet e jetës s'onë. Tue caktuem nji farë rruge, mbas së cilës do të shkojmë, nuk do të shkelim në dërrasë të kalbet e kemi me rrojtun ashtu si na ka hije.

Q. Guranjaku '33.

Manushaqeja.

Manushaqe bukuroshe
Kush të mbolli në këtë qoshe,
Ku shkon ujët e kulluar,
Dal nga dal, tyke kënduar?

Dhe vin' vasha kryelarta,
Me jelek e sumbilla t'arta,
Që kur syt më ty takojnë
Kthehen prap, kuqen e shkojnë?

Pa ndëgjoni dhe bilbilë
Që këndon mbi trëndëfilë...
Pse kaq shpejt këngën pushoi?...
Se një gjemb këmbën i shpoi.

Ku pa sbardhur mirë drita,
Pa lëshuar krahët dita,
Vin' e lahen zoq të sgjedhur
Këngëtor' me zë të dredhur,

Tregom' lulez e bekuar
Kush, vall, ty të ka krijuar,
Të luftosh kryelartësinë
Të shmbllësh dhe bukurinë?

Fluturon, dh' atë ku ra,
Manushaqen ndën të pa.
Lëshon zërin që ta bëjë
Kokën lart ajo të ngrëjë.

Por, si pa, se kot mundohej,
Desh mbi 'të që të lëshohej,
Dhe me sqepin e skalisur
Ta k'put' për t'u-stolisur

Ju Shqiptar, Shqiprin n' e doni,
Manushaqen imitoni,
Esht një lule, thuaj mbret,
Që hunj kryet dhe nuk flet
Kol Gjetha 23.

Vjerrska për shkolla

Durimi.

Me durimin
Kryëj qëllimin,
Dhe ndalesat
E pengesat
S'i përfilli.

Për çdo punë,
Me ç'di unë,
Ky është frëni
Dhe ostëni
Mâ i miri.

Ky është palla
Mâ e rralla
Sot për mue
Për t'luftue
Këtë jetë.

"I duruëmi,
I gëzuëmi,,
Fjal' e urtë
E sigurtë
Ne na thotë.

Prindët.

Dal prej shkolle shkoj n' shtëpi
Plot me shpres' e me gëzim,
Se atie gjëj prindt e mij,
Babë e nanë të shpirtit tim.

Irrok n'qafët, i pushtoj,
Pse më rrisin me dashni
Dhe më çuën qi të mësoj
Sende t'mira e dituni.

Mardnën, t'ftoftin nuk e ndij,
S'e njoj etjen dhe urin,
Kur në gj'i të prindvet t'mij
Unë e shkoj, po, fëminin.

Në çdo vend, qi kam me shkuem,
Kush më pyët, do t'i kallzoj
Se veç t'jerash kam mësuem
Babë e nanë qi të nderoj.

Bonjakja.

Qesh' e vogël, kur muë nana As mjerimi, as idhnija
Më përkundte, m ledhatonte N'zembrën t'eme vend nuk kishin,
E, tuj m'dharë ç më kishte kana, Ishin t'ambla ditt' e mija,
Nina, nina më këndonte. Edhe buzët n'gas më rrijshin..

Nanë, plot gojën unë therritshem Po nashti?.. Ah, un' e shkreta
Kur m'u-rritun shpejt fillova Po blegrij me psheretime,
Dhe në gj'i të 'saj u-hidhshem: Si një qingj pa dele mbeta,
Fëminin në gëzim e shkova, Prandaj qan kjo zemra ime.

Në shtëpi e gjithëkah shkoj
Hijen t'ande shof, o nanë,
Dy, tri pika lot lëshoj,
Pse ti vetëm më ke lanë.

Si një zok pa çerdhe mbeta,
Mbec si qyqë, mbec jetime,
Ah, s'ka vajza më të shkreta
Se sa unë pa nanën t'ime !..

Xixilloja.

Ah, moj xixillojë,
Sa fort qi të due,
Se je porsì zojë
Shum e urtë për mue.

Qe, na erdh pranvera,
Maji u afrue,
E ti vjen ke dera
Tue xixillue.

Digje prej kandilit,
Qi n'kurris e mban,
Dritën e të cilit
Ne na e shpërdan.

Mbramja sa afrohet
Ti zë fluturon,
Natën, si errsohet,
Dritën na lëshon.

E ndo' i plak i njerë,
Kur në terr udhton,
Ti i del përpara
Rrugën ia ndriçon.

S'ta harroj dobinë,
Qi bân në këtë jetë:
Digje për njerinë,
Oh, moj miz' e shkretë!..

Q. Guraniaku '33.

Lajmet e shkollës.

Më 6 Qershuer filloi matura e tridhit e dyshit. Në provat praktike hyni i gjithë rendi, por mbasandej në provimet me gojë e me shkrim u përçua prej sëmundjes së gripës. Kështu prej 37 vetve, qi duhesh të hyjshin në provimet, hynë 28 vetë. nga të cilët fituen këta njëzet veta: Ballshi Haki (Mallakastër), Çeka Jusuf (Gusinjë), Çiftja Haxhi (Elbasan), Çili Xhavit (Korçë), Gogoni Dhimitër (Libohovë), Hasmema Ibrahim (Tiranë), Idrizi Ali (Vlonë), Kadilliu Mustafa (Pogradec), Keçi Abdyl (Shijak), Koçilja Qemal (Peqin), Kola Hysen (Elbasan), Korbi Xhaferr (Lumë), Kushi Vasil (Shkodër), Ndrija Nos (Elbasan), Osmani Kamer (Elbasan), Spase Sterjo (Korçë), Shehu Mynir (Peshkupi), Shishmani Ibrahim (Elbasan), Vaska Vasil (Korçë), Zhiiti Hekuran (Skrapar).

Më '32 fitoi maturën edhe Shpendi Rexhep '31.

Ata, qi i u-larguen provimevet nga shkaku i sëmundjes janë: Babameto Neim, Ballka Nexhmi, Bimi Beqir, Çano Selahedin,

Kekuci Fot, Këri Ferhat, Koçi Gjergj, Sulejmani Nijazi edhe Shtylla Azis.

Dalshin faqe bardhë këta shokë, qi sëmundja nuk i lã të hyjshin si gjithë të tjerët në provimet.

Më 7 Korrik Normalisti shtetitë filloi shtetitjen, për të cilën është mundue vitre me radhë E nisi udhëtimim nga Korça e, tue i ranë qark jugës e veriut. do të kërchet prap n' Elbasan, ku do të mbarojnë udhëtimin e bashkë me këtë edhe jetën vllaznore të njëj shoqniqe të mbarë.

Për tu lavdue është ky rend prandaj i qoftë udha e mbarë dhe u-kthefshin me thesare kujtamesh të vendeve të bukra t'atdheut t'onë.

Problemën e botueme në numrin 5 të Normalistit e zgjodhi më sëpari tregtari Zoi Dhima. ktij i u-dërgue dhurata e dhanun prej shokut t'onë. Li Durollit 35. Këtë problemë e zgjidhën edhe shum vetë të tjerë: me këtë rasë muerëm vesh se Normalisti i ynë ka mjaft këndonjes.

Gëzohejm, se ai qi këndon, meson, e qëllimi i ynë është qi t'i ndifim me çdo farë mënyre ngritjes së një shkalle më të naltë se sa jemi.

Tridhit e dyshit i është bãmë qejfi shum prej prof. Z. Karl Ljares, i cili n'orën e fundit të mësimit të vet u mbajti një fjalim me fjalë të mira e këshilluese. I falet nderit shum.

MBRETNIJA SHQIPTARE.

Ministria e Arsimit.

Nr. 1490.

Tiranë, më 2/VI 1932.

Q A R K O R E.

Sikurse informohemi, shumë prej Arsimtarve janë pajue dhe marrin të Përkohshëmën "Normalisti, e cila shkruhet prej një grupi kandidatësh mësues, studenta të Normalës Shtetnore t' Elbasanit.

SHKURTIMI: Mbi pagesën e abonamenteve të së për-kohshëmes "Norma- Mbajtja në kambë e kësaj së Përkohshë- listi „ me kërkon prej grupit, në fjalë mund e

kujdes të math e çka më tepër, edhe sakrificat jo fort të vogla financiare.

Si studenta që janë, gjendja financiare e tyre është aq e vogël sa që, po të mos kishin uzdajen e pështetun tek shokët e tyre Normalista të dalun nga gjiu po i kësaj Normalje e tek gjithë ZZ. mësueset e mësueset që shërbejnë në karrierën e shejtë të Arsimit, ky grup iniciator, veprën e tij të sotshme nuk do t'a kishte fillue.

Me qëndrën pra se ky grup pret ndihmën nga gjithë Arsimitarët, e sidomos në një mënyrë të posaçme nga ish nxënësit e Institutit në fjalë, janë të lutun e të porositun në një mënyrë të posaçme gjithë pajtimtarët edhe ata që dëshirojnë të pajtohen me ja dërgue Drejtimit të së Përkohshmes pajtimin e tyre, që nuk është më tepër se 2 fr. ari në vjet.

Ministr' i Arsimit :

Hil Mosi d. v.

Drejtoris së shkollës Normale

Elbasan.

Për njoftim e në përgjegje të shkresës s' atjeshme Nr. 167 me datë 10 / V / 932 këtu-mbrapa ju komunikohet qarkorja e kësaj Ministrije. drejtue të gjithë Inspektorivet, Drejtorivet dhe Kryemësuesivet të shkollave.

P. Ministr' i Arsimit :

A. Xhuvani d. v.

Me anën e qarkores Nr. 1490 me datën 2 / 6 / 932, që na çoi Ministrija e Arsimit, marrim vesh se i lutei e i porosit me një mënyrë të posaçme të gjithë arsimitarët e arsimitarët, të gjithë pajtimtarët dhe ata që dëshirojnë të pajtohen për me u-kujdesun e për me përkrahun të përkohshmen Normalisti dhe me i dërguem pajtimet e tyre drejtimit të së Përkohshmes.

Ky është një nder i math që po na bën Ministrija e jonë

e i falemi nderit shum. Jemi tepër të kënaqun kur më të më dhejt e më të parët t' onë i çmojnë veprat t' ona sado të vogla; kështu marrim më tepër zemër, qi të shkojnë gjithnji nga e mira e nga e mbara dhe të mos kursejmë mundin t' onë për përparimin e lumtënin e atdheut.

Problema

Nji mbret, kur po shetitte me nji kal, i duel përpara nji grue, e cila i tha: "O ti mbret i hypun mbi kalin e palemun e mbi shalën e nanës së 'tij të lutem më liro nga burgu djalin t'em. burrin e nanës s'eme?". Mbreti, i çuditun prej kësaj probleme, ia liroi asaj atë qi kërkonte. Si munden me u-spjeguem fja et e grues?

Tre burra bashkë me tri grat e 'tyne duen me kaluem nji lum në buzë të të cilit gjindet nji lundër pa njeri, qi nuk merr më tepër se dy vetë. Si munden me kaluem ata pa u-përzimun nji burrë me gruen e tjetrt?

Mbassi hangrën drekë tre vetë në nji gjelltoe. pyetën gjellë-bâmësin se sa të holla duhesh me paguem seicili. Ai u tha: "delni me radhë e seicili le të lājë aqë të holla, sa gjinden mbrenda në kasë e le të marri nji grosh prej 'saj". Sa të holla kishte kasa në fillim tue dijtun se kjo në fund mbeti bosh?

Pali nji ditë i tha Petrit: Sa vjeç jeni ju? Ai u-përgjegj: "Unë kam dy herë moshën qi kishit ju, kur unë kishjem moshën qi keni ju tash e. kur do të keni ju moshën qi kam unë tash, shuma e të dy moshave do të jetë gjashtë dhjetë e tre". Sa vjeç ishin seicili?

Kush i gjen, merr nji pajtim të Normalistit.

Xh. Korbi '32.

kujdes të math e çka më tepër, edhe sakrificat jo fort të vogla financiare.

Si studenta që janë, gjendja financiare e tyre është aq e vogël sa që, po të mos kishin uzdajen e pështetun tek shokët e tyre Normalistat të dalun nga gjiu po i kësaj Normalje e tek gjithë ZZ. mësuesit e mësueset që shërbejnë në karrierën e shejtë të Arsimit, ky grup iniciator, veprën e tij të sotshme nuk do t'a kishte fillue.

Me qënë pra se ky grup pret ndihmë nga gjithë Arsimitarët, e sidomos në një mënyrë të posaçme nga ish nxënësit e Institutit në fjalë, janë të lutun e të porositun në një mënyrë të posaçme gjithë pajtimtarët edhe ata që dëshirojnë të pajtohen me ja dërgue Drejtimit të së Përkohshmes pajtimin e tyre, që nuk është më tepër se 2 fr. ari në vjet.

Ministr' i Arsimit:

Hil Mosi d. v.

Drejtoris së shkollës Normale

Elbasan.

Për njoftim e në përgjegje të shkresës s' atjeshme Nr. 167 me datë 10 / V / 932 këtu-mbrapa ju komunikohet qarkorja e kësaj Ministrije, drejtue të gjithë Inspektorivet, Drejtorivet dhe Kryemësuesivet të shkollave.

P. Ministr' i Arsimit:

A. Xhuvani d. v.

Me anën e qarkores Nr. 1490 me datën 2 / 6 / 932, që na çoi Ministrija e Arsimit, marrim vesh se i lutei e i porosit me një mënyrë të posaçme të gjithë arsimitarët e arsimitarët, të gjithë pajtimtarët dhe ata që dëshirojnë të pajtohen për me u-kujdesun e për me përkrahun të përkohëshmen Normalisti dhe me i dërguem pajtimet e tyre drejtimit të së Përkohshmes.

Ky është një nder i math që po na bën Ministrija e jonë

e i falemi nderit shum. Jemi tepër të kënaqun kur më të më dhejt e më të parët t' onë i çinojnë veprat t' ona sado të vogla; kështu marrim më tepër zemër, qi të shkojnë gjithnji nga e mira e nga e mbara dhe të mos kursejmë mundin t' onë për përparimin e lumtënin e atdheut.

Problema

Nji mbret, kur po shetitte me nji kal, i duel përpara nji grue, e cila i tha: "O ti mbret i hypun mbi kalin e palemun e mbi shalën e nanës së 'tij të lutem më liro nga burgu djalin t'em. burrin e nanës s'eme?". Mbreti, i çuditun prej kësaj probleme, ia liroi asaj atë qi kërkonte. Si munden me u-spjeguem fja et e grues?

Tre burra bashkë me tri grat e 'tyne duen me kaluem nji lum në buzë të të cilit gjindet nji lundër pa njeri, qi nuk merr më tepër se dy vetë. Si munden me kaluem ata pa u-përzimun nji burrë me gruen e tjetrt?

Mbassi hangrën drekë tre vetë në nji gjelltoe. pyetën gjellëbâmësin se sa të holla duhesh me paguem seicili. Ai u tha: "delni me radhë e seicili le të lājë aqë të holla, sa gjinden mbrenda në kasë e le të marri nji grosh prej 'saj". Sa të holla kishte kasa në fillim tue dijtun se kjo në fund mbeti bosh?

Pali nji ditë i tha Petrit: Sa vjeç jeni ju? Ai u-përgjegj: "Unë kam dy herë moshën qi kishit ju, kur unë kishjem moshën qi keni ju tash e. kur do të keni ju moshën qi kam unë tash, shuma e të dy moshave do të jetë gjashtë dhjetë e tre". Sa vjeç ishin seicili?

Kush i gjen, merr nji pajtim të Normalistit.

Xh. Korbi '32.

